

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESİ

MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

ndërmjet

Komunës së Gjiçanit, si autoritet publik

dhe

Remzije Ramadani nga Gjiçani, përfituese

Gjiçan, 2023

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja financiare për shërimin e Remzije Ramadanit nga Gjilani, sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren 01. nr. 016-126422 dt. 29.12.2016 e ndryshuar dhe plotësuar me rregulloren nr. 2/208,01 nr. 016-28468 dt. 22.03.2018 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve (neni 21 paragrafi 3.1)

Neni 2
Vlera e Subvencionimit

1. Vlera e subvencionimit është shuma prej **500 €** (pesëqind euro) dhe ndahet nga Kodi Buxhetor-Subvencione -Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3
Obligimet e palëve

1. Obligimet e përfitueses së subvencionit janë :

- 1.1.mjetet e marra, përfituesja do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet e paraqitura në projekt.
- 1.2.përfituesja duhet të raportoj tek Komuna e Gjilanit brenda 30 ditëve, pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.

2. Përfituesja duhet të sjellë tek Komuna e Gjilanit:

- 2.1.raportin narrativ (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje) raportin financiar për mjetet e shpenzuara (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje)
- 2.2.njofton Komunën e Gjilanit për çdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit

Neni 4

1. Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:

- 1.1.obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje, t'ia transferoj në xhirollogarinë bankare të përfitueses sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;
 - 1.2.bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.
- 2. Komuna e Gjilanit mban të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.**

Neni 5
Afatet kohore

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.
2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

Neni 6
Shkëputja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rast të:
 - 1.1. tejkalimit të pa justifikuar të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje;
 - 1.2. marrëveshjes me shkrim nga të dyja palët në marrëveshje;
 - 1.3. shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë paraqitur me këtë marrëveshje dhe
 - 1.4. mos realizimit të subvencioneve për shkaqe objektive.

Neni 7
Kthimi i mjeteve

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve apo zvogëlojnë punën sipas vëllimit të paraparë me projekt, përfituesja është e obliguar t'i kthejë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.


Neni 10


Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta për secilën palë.

Komuna e Gjilanit
Alban Hyseni, Kryetar



Remzije Ramadani





REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjiçlanit merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **500 (pesëqind euro)** për Remzije Ramadanin për shërim.
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Mjetet derdhen në xhironlogarinë e përfitueses nr. **1507030002276948** Raiffeisen Banka.
4. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionim e përfitueses.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dorëzohet:

- Përfitueses,
- DB, DSHMS dhe
- Arkivit.

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni

